KOMITETI EKZEKUTIV

Biografi

Z. DRITAN MUSTAFA
DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Z. Dritan Mustafa është pjesë e Tirana Bank që nga muaji dhjetor 2014. Në janar 2015 u emërua Drejtor I Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank. Ai është përgjegjës për qeverisjen e institucionit, udhëheqjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve strategjike me klientët dhe bashkëpunëtorët, si dhe për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të Bankës. Gjithashtu Z. Mustafa është anëtar i Këshillit Drejtues si edhe mban përgjegjësitë e Drejtuesit të Komitetit Ekzekutiv të Tirana Bank.

Që nga viti 1995, Z.Mustafa ka mbajtur role të ndryshme funksionale dhe drejtuese pranë institucioneve bankare në tregun lokal, si Banka Credit Agricole, Banka Kombëtare e Greqisë dhe Banka Kombëtare Tregtare, duke sjellë me vete një eksperiencë shumë vjeçare në fusha të ndryshme të aktivitetit bankar. Gjatë periudhës 2007-2014 ka mbajtur rolin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm në Bankën Credit Agricole.

Z. Mustafa është diplomuar në Universitetin e Tiranës në degën Administrim Biznesi dhe zotëron një diplomë Master për Administrim Biznesi akorduar nga International Hellenic University, Greqi.

Z. OLIVIER BAUR
NËNDREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Z. Olivier Baur është pjesë e Tirana Bank që nga muaji tetor 2023, në rolin e Nëndrejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. Ai është përgjegjës për drejtimin dhe nxitjen e transformimeve dhe zhvillimeve digjitale, teknologjisë së informacionit, si dhe për planifikimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve operacionale.

Z. Baur është shtetas francez dhe sjell me vete një përvojë të gjatë në role drejtuese në sektorin bankar që prej vitit 2005. Përgjatë periudhës 2018-2023 ai ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Operacioneve pranë Grupit BCIMR-BRED, Dijbouti Grup ku gjithashtu ka shërbyer si Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtor i Operacioneve. Në 2012-2015, ai ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Operacioneve & Financës pranë Societe Generale Guinea. Për periudhën 2008-2012 ka qenë pjesë e Societe Generale Albania, ku ka mbajtur pozicionet e Drejtorit të Projekteve, Drejtorit të Operacioneve dhe Nëndrejtorit të Përgjithshëm.

Z. Baur ka përfunduar studimet në degën e Inxhinierisë në Supelec dhe zotëron një diplomë Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike nga Instituti i Teknologjisë në Georgia, SHBA.

ZNJ. MANJOLA CAPO
DREJTUESE E DIVIZIONIT TË KREDISË

Znj. Manjola Capo është pjesë e Tirana Bank që nga muaji qershor 2005, në rolin e Drejtueses së Divizionit të Kredisë. Ajo është përgjegjëse për mbikqyrjen dhe menaxhimin e riskut të portofolit të kredive, duke siguruar që ky portofol të jetë i shëndetshëm në përputhje me kuadrin rregullator dhe standardet më të mira të kredidhënies.

Karrierën e saj e nisi në Divizionin e Biznesit, linja Korporatë, duke mbajtur disa pozicione progresive përfshirë edhe atë të Zv. Drejtorit. Në shtator 2010 u emërua Drejtuese e Divizionit të Kredisë. Gjatë eksperiencës së saj në Tirana Bank, Znj. Capo ka kontribuar ndjeshëm në dy sektorë të rëndësishëm, Biznesin dhe Riskun e Kredisë, duke dhënë një kontribut të vlefshëm në zhvillimin e portofolit të kredive dhe menaxhimin e rrezikut të tij.

Znj. Capo është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Dega e Ekonomiks. Në po të njëjtin Universitet ka kryer studimet pas universitare, Dega Bankë.

ZNJ. ELONA GJIPALI
DREJTUESE E DIVIZIONIT TË REKUPERIMIT BANKAR

Znj.Elona Gjipali është pjesë e Tirana Bank që nga muaji tetor 2001, në rolin e Drejtueses së Divizionit të Rekuperimit Bankar. Ajo është përgjegjëse për monitorimin dhe menaxhimin e portofolit të kredive me probleme, administrimin e aseteve të paluajtshme të Bankës, përfshirë edhe ato të marra në pronësi nga procesi i ekzekutimit.

Znj. Gjipali e nisi karrierën e saj pranë Tirana Bank në tetor 2001. Para se të emërohej në pozicionin aktual në maj 2013, gjatë periudhës 2001-2013 ka mbajtur pozicionin e Drejtueses së Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, duke dhënë një

kontribut të rëndësishëm në ndërtimin dhe zhvillimin e funksioneve të Kontrollit të Brendshëm.

Znj.Gjipali është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës për Ekonomi si dhe zotëron një diplomë Master në Drejtim Bankar nga Universiteti "New York" i Tiranës.

ZNJ. ELVIRA KAPOLI
DREJTUESE E DIVIZIONIT TË FINANCËS

Znj.Elvira Kapoli është pjesë e Tirana Bank që nga muaji shkurt 2019, në rolin e Drejtueses së Divizionit të Financës. Ajo është përgjegjëse për ecurinë financiare të Bankës dhe mbikqyrjes së disa funksioneve përfshirë Kontabilitetin, Kontrollin Financiar, Thesarin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit.

Me një eksperiencë të gjatë në fushën e financave, Znj. Kapoli ka qenë pjesë e Procredit Bank, ku ka mbajtur pozicionin e Drejtueses së Divizionit të Financës gjatë periudhës 2007-2018. Në 2003-2007 ka qenë pjesë e Deloitte Albania, ku filloi si Asistent Auditore, duke u promovuar më pas si Auditore e Lartë.

Znj. Kapoli është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës për Financë-Kontabilitiet, zotëron një diplomë Master Shkencor dhe një Diplomë Pasuniversitare nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, Menaxhimit, Marketingut dhe Financës në Qendrën Ndërkombëtare të Studimeve Mesdhetare të Avancuara në Kretë, Greqi.

ZNJ. LILA CANAJ
DREJTUESE E DIVIZIONIT RETAIL

Znj. Lila Canaj është pjesë e Tirana Bank që nga muaji maj 2013, në rolin e Drejtueses së Divizionit Retail. Ajo është përgjegjëse për menaxhimin e Biznesit Retail, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e objektivave strategjike, identifikimin dhe zbatimin e iniciativave që përqendrohen në inovacion, si dhe zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të këtij segmenti.

Që nga viti 2005, Znj. Canaj ka mbajtur role të ndryshme drejtuese pranë institucioneve bankare. Karriera e saj nisi pranë Bankës Raiffeisen përgjatë periudhës 2005-2010. Më pas iu bashkua Procredit Bank në pozicionin e Drejtueses së Linjës së Biznesit për segmentin Retail dhe Institucionet Publike, angazhim të cilin e mbajti përgjatë 2010-2013. Në pozicionin aktual pranë Tirana Bank është emëruar në mars 2019.

Znj. Canaj është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës për Administrim Biznesi si dhe ka përfunduar studimet pranë Harvard Business Publishing në "Manage Mentor Programme".

ZNJ. GLENDA KURTI
DREJTUESE E DIVIZIONIT TË KORPORATAVE

Znj.Glenda Kurti është pjesë e Tirana Bank që nga muaji mars 2019, në rolin e Drejtueses së Divizionit të Korporatave. Ajo është përgjegjëse për menaxhimin e linjës së biznesit korporatë duke zhvilluar dhe drejtuar një nga portofolet më të rëndësishëm të bankës.

Znj. Kurti ka një përvojë të gjatë në sektorin bankar. Ajo ka qenë pjesë e Raiffeisen Bank në periudhë 2006-2011 në Departamentin e Korporatave Ndërkombëtare, ku vitin e fundit ka drejtuar këtë Departament. Përgjatë periudhës 2012-2019 ka mbajtur rolin Drejtues në linjën e Biznesit Korporatë pranë Bankës Societe Generale.

Znj. Kurti është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës për Administrim Biznesi dhe zotëron një diplomë Master në Administrim Biznesi nga Universiteti Epoka, Shqipëri

ZNJ. BRISILDA KOTA (BALA)
DREJTUESE E MANAXHIMIT TË RISKUT

Znj. Brisilda Kota (Bala) është pjesë e Tirana Bank që nga muaji gusht 2013, në rolin e Drejtueses së Manaxhimit të Riskut. Ajo është përgjegjëse për zhvillimin e strategjive të administrimit të riskut, duke u siguruar se Banka operon brenda niveleve të pranuara të rrezikut, përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

Znj. Kota ka një eksperiencë të gjatë në sektorin bankar, duke filluar karrierën e saj pranë Bankës së Shqipërisë, ku punoi përgjatë viteve 2007-2009 si specialiste në Departamentin e Mbikëqyrjes. Duke vijuar përgjatë periudhës 2009-2013 pranë Bankës Societe Generale Albania, në pozicionin e përgjegjëses së sektorit të Menaxhimit të Kredisë dhe Rreziqeve të Tregut. Në Shkurt 2022, Znj. Kota është emëruar anëtare e Komitetit Ekzekutiv të Tirana Bank.

Znj. Kota është diplomuar në degën Financë dhe Kontabilitet pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe mban titullin Analist Financiar i Certifikuar nga Instituti nderkombetar i profesionisteve, Charted Financial Analyst (CFA).

#çfarëdotëarrishsot?

TIRANA BANK